

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK. Nr. 246/2020**

**Datë: 26 tetor 2020**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Nexhat Aliu, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Gjilan, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/16/2019-AD/GJTHGJ/04/19, të datës 9 qershor 2020, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 26 tetor 2020, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 240-të, të mbajtur më datë 26 tetor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Nexhat Aliu**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5 paragraf 1, nën paragraf 1.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**A r s y e t i m**

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.18/2020, të datës 27 janar 2020, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/16/2019-AD/GJTHGJ/04/19, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Nexhat Aliu, i cili dyshohet se për lëndën penale PP.nr.76/2019, në seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e paraburgimit ka lejuar që të merr pjesë edhe e dëmtuara përkatësisht bashkëshortja e të pandehurit, të cilës i është dhënë mundësia e deklarimit lidhur me çështjen e paraburgimit të të pandehurit. Këto veprime nga parashtruesi i ankesës janë konsideruar që bien në kundërshtim me parimin 5 të Kodit të etikës për gjyqtar.

Për të shqyrtuar këtë çështje Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 26 tetor 2020 ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën morën pjesë Kryesuesi i panelit hetimor Gëzim Pozhegu dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Nexhat Aliu. Kryesuesi i panelit hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron pranë raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura dhe ka kërkuar nga KGJK që të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga gjyqtari Nexhat Aliu gjatë procedimit të lëndës PP.nr.76/2019.

Gjyqtari Nexhat Aliu, në seancën dëgjimore ka deklaruar se nuk ka bërë shkelje disiplinore gjatë seancës për caktimin e paraburgimit në lëndën PP.nr.76/2019 për lejimin e prezencës së të dëmtuarës dhe se është në diskrecion të gjyqtarit për të vendosur për masën që do ti caktohet të

pandehurit që në këtë rast ka caktuar masën që është konsideruar adekuate për rastin konkret, ka shtuar se ky vendim edhe është atakua dhe është kthyer në rivendosje nga Gjykata e Apelit për mos arsyetim të mjaftueshëm, e jo për prezencën e të dëmtuarës.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, KGJK administroj provat materiale siç janë: Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës 9 qershor 2020, kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor e datës 26 dhjetor 2019, shkresat e lëndës penale PP.nr.76/2019, procesverbalin e shqyrtimit fillestar të datës 20 maj dhe 9 qershor 2020.


Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se gjyqtari Aliu në seancën për caktimin e paraburgimit në lëndën PP.nr.76/2019 të datës 4 dhjetor 2019, ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5 paragraf 1, nën paragraf 1.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kur në seancën dëgjimore ka lejuar që të merr pjesë e dëmtuara përkatësisht bashkëshortja e të akuzuarit.

Nga provat e prezantuara nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, përkatësisht nga shkresat e lëndës penale DKR.P.nr.43/2011, nuk u vërtetua se gjyqtari Nexhat Aliu gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës PP.nr.76/2019 të ketë bërë ndonjë shkelje disiplinore të sanksionuar me Ligjin mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. KGJK vlerëson se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i të drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës së pakënaqur në gjykatën e instancës më të lartë e që kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbej si kriter me rastin e vlerësimit të performancës së gjyqtarit nga Komisioni për Vlerësimin e Përformancës së Gjyqtarëve në KGJK, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit, një veprim procedural i ndërmarr nga gjyqtari.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.246/2020, datë: 26 tetor 2020**

**Skender ÇOÇAJ,**  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**



**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Ramiz Azizi, Kryetar, Gjykata Themelore në Gjiilan;
- Nexhat Aliu, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Gjiilan;
- Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;
- Arkivit.